

VENDIM
Nr.859, datë 12.6.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT VENDOR “REX”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht sipas vendimit nr.850 të KKRT-së, datë 24.4.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televisionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Rex Mundi” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor, në fushën e transmetimeve analoge për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në qarkun e Korçës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZV/KRYETARI
Alban Karapici